

Instituti për Studime të Avancuara GAP

# Deçani – Raporti komunal

Nëntor 2009

## Deçani në shifra

|   |  |                                       |
|---|--|---------------------------------------|
| Popullsia   | Gjithsej   | 53978                                 |
|   | Shqiptarë  | 99%                                   |
|   | Ashkali  | 1%                                    |
| Gjeografia  | Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )  | 371                                   |
|   | Numri i fshatrave  | 42                                    |
| Shkollimi   | Pa shkollë/ filllore e papërfunduar  | 13.42%                                |
|   | Filllore/ e mesme e papërfunduar   | 38.89%                                |
|   | E mesme  | 35.19%                                |
|   | Shkollë e lartë  | 11.57%                                |
|   | Universitet  | 0.93%                                 |
|   | Nr. i nxënësve   | 8585                                  |
|   | Nr. i mësimdhënësve  | 475                                   |
|   | Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)  | 3                                     |
|   | Nr. i shkollave filllore (me paralele të ndara)  | 20                                    |
|   | Nr. i çerdheve   | 0                                     |
|   | Shëndetësia  | Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare |
| Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore |  | 10                                    |
| Nr. i mjekëve   |  | 35                                    |
| Papunësia   | Gjithsej   | 64.72%                                |
|   | Meshkuj  | 60.60%                                |
|   | Femra  | 74.60%                                |
| Të punësuar   | Fuqi punëtore (15-64 vjet)   | 32,927                                |
|   | Të punësuar në sektorin publik komunal   | 813                                   |
| Buxheti 2009  | Gjithsej (Euro)  | 4,239,773                             |
|   | Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)   | 370,000                               |
|   | Të hyrat tjera (Euro)  | 3,869,000                             |
| Shpenzimet e realizuara (2008) <sup>1</sup>           | Gjithsej (Euro)  | 3,385,108 (91%)                       |
|   | Shpenzimet kapitale (Euro)   | 665,089 (70%)                         |
|   | Shpenzimet tjera (Euro)  | 2,719,673 (98%)                       |
| Rezultatet e zgjedhjeve lokale 2007                   | AAK  | 47.80%                                |
|   | LDD  | 20.83%                                |
|   | LDK  | 18.13%                                |
|   | AKR  | 6.77%                                 |
|   | PDK  | 5.54%                                 |
|   | Tjera  | 0.94%                                 |
| Kryetarët e Komunës 2000-2009                         | 2000-2002: Mehmet Bojkaj (LDK)<br>2002-2007: Ibrahim Selmanaj (AAK), Nazmi Selmanaj (AAK)<br>2007-2009: Musa Berisha (AAK) |                                       |

<sup>1</sup> Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

## Shkurt për Deçanin

Komuna e Deçanit shtrihet në perëndim të Kosovës dhe është pjesë përbërëse e rajonit të Dukagjinit. Përveç se kufizohet me dy komuna tjera të Kosovës, Pejën dhe Gjakovën, Deçani kufizohet edhe me dy shtetet fqinje, Shqipërinë dhe Malin e Zi. Qyteza e Deçanit bashkë me 42 fshatrat e kësaj komune përbëjnë një territor prej 371 km<sup>2</sup>. Ka një popullatë prej 53,978, ku 99% e tyre janë shqiptar. Ekonomia varet kryesisht nga bujqësia. Klima e mirë dhe uji i pastër i jep Deçanit një përparësi për zhvillimin e turizmit dimëror dhe atij veror. Bjeshkët e Nemuna dhe Manastiri i Deçanit janë dy nga atraksionet më të mëdha turistike.

## Problemet aktuale

Komuna e Deçanit ka qenë mjaftë e dëmtuar nga lufta. Papunësia dhe varfëria janë problemet kyçe të kësaj komune. Nga numri i përgjithshëm 54,000 banorëve, 32,900 janë të aftë për punë, por 64.7% e tyre nuk mund të gjejnë një vend pune. Deçani është një nga tri komunat me numrin më të madh të papunësisë. Vetëm në Qendrën Komunale për Punësim janë të regjistruar 12,695 të papunë apo 38.5% e popullsisë së papunë. Por shifrat e Qendrës Komunale të Punësimit nuk japin një pasqyrë të qartë të papunësisë, pasi që shumë qytetarë nuk kërkojnë punësim përmes kësaj qendre. Edhe varfëria është problem që prek shumë familje. 1,214 familje me 5,758 anëtarë janë të varur nga ndihmat sociale (10.6% e popullsisë).

Me gjithë investimet që janë bërë, kjo komunë ende ballafaqohet me probleme të përgjithshme infrastrukturore. Kanalizimi paraqet një problem që kërkon zgjidhje urgjente nga organet kompetente. Mungesa e një deponie për hedhjen e mbeturinave ka ngarkuar edhe më tepër ambientin. Kur ia shton kësaj edhe prerjen e pyjeve, del se çështja e ambientit në Komunën e Deçanit është problem serioz. Në mesin e problemeve të kësaj komune ato që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme janë:

- Mungesa e kanalizimit
- Mbeturinave
- Mungesa e rrjetit të ujësjellësit
- Mosfunktionalizimi i pushimores së fëmijëve
- Prerja e pyjeve

Komuna e Deçanit është e vetmja komunë e cila nuk e ka të rregulluar **sistemin e kanalizimit** në qytet. Ky është problem shumëvjeçar dhe është shumë shqetësuese për banorët e komunës së Deçanit meqë kanalizimet derdhen kudo, e sidomos në lumin e Deçanit i cili kundërmon dhe është burim i infeksioneve të ndryshme. Projekti për ndërtimin e kanalizimit është hartuar gjatë këtij mandati, sidoqoftë nuk janë paguar parat për hartuesin e projektit, prandaj edhe punët janë ndërprerë; e për më tepër komuna e Deçanit është në kontest gjyqësor me autorin e hartuesit të projektit në fjalë. Përveç në qyteti, kanalizimi mungon edhe nëpër shumë fshatra.

Hedhja pavend e **mbeturinave** është gjithashtu një nga problemet kryesore me të cilin ballafaqohen qytetarët. Ndërmarrja "Higjiena", ende nuk e ka të zgjedhur statusin e saj juridik. Komuna ka marrë vendim që menaxhimi i mbeturinave të mos bëhet nga kompania rajonale, mirëpo edhe ky vendim nuk ka ndikuar në zgjidhjen e këtij problemi. Në Deçan nuk ka deponi për grumbullimin dhe ndarjen e

mbeturinave. Deponia më e afërt është ajo në Sferk të Pejës. Për shkak të vështirësive për tu transportuar, mbeturinat e grumbulluara në Deçan nuk dërgohen në Sferk por digjen nëpër kontejnerë dhe në afërsi të vendbanimeve. Nga djegia e herë pas hershme e këtyre mbeturinave, kundërmon edhe qyteti i Deçanit. Gjendja në viset rurale është edhe më e rëndë. Në zonat rurale grumbullimi i mbeturinave bëhet nga "Agjencioni për Pastrim Rural", të cilët mbledhin mbeturinat e banorëve të këtyre viseve çdo të dytën javë për një pagesë prej 2,5 euro. Mbeturinat mund të vërehen kudo në qytetin e Deçanit, shpesh edhe në afërsi të shkollave dhe ambulancave.

**Mungesa e rrjetit të ujësjellësit** në më shumë se 10 fshatrat e komunës së Deçanit është gjithashtu një problem i madh për banorët. Fshatrat si Prilep, Irzniq, Prekolluk, Glllogjan, Shaptej, Gramaçel, Dubravë, Rastavicë, Baballoq, etj. nuk kanë ujë të pijshëm. Prej shumë vitesh ekziston një projekt për shtrirjen e ujësjellësit në këto fshatra i cili është financuar pjesërisht nga Agjencioni Evropian për Rindërtim, mirëpo punët nuk kanë përfunduar për disa arsye, si mungesa e përkushtimit të komunës që të kyç edhe komunitetin në participim, vjedhja e pompave për rritjen e shtypjes, etj.

**Zona e mbrojtur përreth Manastirit të Deçanit.** Manastiri i Deçanit është një nga objektet më të vjetra fetare në këtë komunë. Sipas Pakos së Ahtisaarit, Manastiri i Deçanit është objekt i trashëgimisë fetare serbe dhe i ndahet një zonë prej 80 hektarësh e cila konsiderohet si zonë e veçantë. Banorët që kanë pronat e tyre në këtë pjesë kanë vështirësi që ti vizitojnë ato dhe të gjithë pronarët e kësaj pjese ankohen me kufizimet që i bëhen atyre. Edhe pse pothuajse të gjithë e konsiderojnë Manastirin si pjesë të tyre që duhet mbrojtur, masat e aplikuara nga KFOR-i italian dhe udhëheqësit e Manastirit ata i konsiderojnë të tepërta. Përveç pronave, edhe pushimorja e fëmijëve mbetet e pa shfrytëzuar. Kjo pushimore ka 110 shtretër dhe më herët është shfrytëzuar për vizita të nxënësve dhe aktivitete të ndryshme rinore. Tani në të janë vendosur ushtarët e KFOR-it. Edhe pse është atraksion turistik, Manastiri i Deçanit aplikon masa të rrepta për vizitorët dhe jo çdokush mund të vizitojë atë. Projekti i komunës për ndërtimin e një rruge që do të lidhte Deçanin me Plavën nuk ka mund të realizohet, sërish pengesë për këtë ka qenë zona e mbrojtur përreth Manastirit.

**Prerja e pyjeve.** Deçani është një komunë ku pjesa më e madhe e territorit të saj është e mbuluar me male. Kjo trevë paraqet atraksion për turistët, mirëpo, përkundër kësaj, kjo pasuri natyrore po shkatërrohet si pasojë e prerjes së pyjeve. Pas Istogut, Deçani është komuna e cila më së shumti ka pasur prerje ilegale të pyjeve gjatë vitit 2008. Sipas statistikave të policisë, në këtë komunë gjatë vitit 2008 janë regjistruar 168 raste të prerjes së pyjeve. Menaxhimi i pyjeve nga viti i ardhshëm do të kalojë në kompetencë të komunës, pasi që deri më tani me pyjet ka menaxhuar Agjencioni Pyjor i Kosovës.

## Premtimet dhe puna e Kryetarit të Komunës

Në mandatin e parë qeverisës, kur zgjedhjet mbaheshin vetëm për përfaqësuesit e Kuvendit Komunal, si kryetarë i komunës ka shërbyer për dy vite Mehmet Bojkaj nga LDK. Dy vite më vonë, AAK fitoi shumicën e ulëseve në KK dhe rrjedhimisht i takoi edhe posti i kryetarit të Komunës. Kryetar komune u zgjodh Ibrahim Selmanaj,

i cili në mars 2005 la postin e kryetarit për postin e ministrit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Në periudhën 2005-2007 si kryetar komune u zgjodh Nazmi Selmanaj. Në zgjedhjet e treta lokale kryetar komune u zgjodh Musa Berisha nga AAK. Musa Berisha fitoi 6,736 vota apo 39.4% të votave. Ndërkaq, në zgjedhjet e balotazhit ai fitoi 7,046 vota apo 68.1%.

Premtimet kryesore të dhëna gjatë fushatës zgjedhore kishin të bënin, ndër të tjera, edhe me shtrirjen e rrjetit të kanalizimit, investimi në Bjeshkët e Nemuna dhe rritja e turizmit, ndërtimi i rrugës Deçan-Plavë. Tabela më poshtë pasqyron disa nga premtimet e dhëna në debatet zgjedhore të mbajtura në “Jeta në Kosovë” dhe realizueshmëria e tyre pas dy vitesh.

Tab.1. Premtimet dhe realizueshmëria e tyre

| Premtimet   | Realizimi   |
|---|---|
| Fillimi i zbatimit të projektit për shtrirjen e kanalizimit për qytetin e Deçanit që përfshinë edhe Belegun, një pjesë të Isniqit dhe të dy Carrabregat | Ky projekt nuk është realizuar. Edhe më tutje qyteti i Deçanit është pa rrjet të kanalizimit.   |
| Implementimi i planit të detajuar të hartuar nga AAK për potencialet natyrore që ka Deçani dhe për Bjeshkët e Deçanit;                                  | Ky projekt nuk është realizuar. Edhe pse komuna ka një plan për zhvillimin e turizmit në këtë komunë, sidomos në Bjeshkët e Deçanit, komuna thotë se për shkak të problemeve politike me Manastirin ky premtim nuk është realizuar.   |
| Do të ndërtoj rrugën Deçan-Plavë  | Ky premtim nuk është përmbushur meqë duhet të kalohet përmes Manastirit. Sipas komunarëve ky është problem politik dhe nuk ka mundësi për diskutime, mirëpo disa qytetarë mendojnë se komunarët do të mund të përdridhnin rrugën dhe kështu të bëhej asfaltimi i një rruge të rëndësishë së lartë për banorët e komunës së Deçanit. |

## Zgjedhjet lokale në Deçan

Partitë më të mëdha për nga numri i përkrahësve në komunën e Deçanit janë AAK dhe LDK. Që nga zgjedhjet e para të vitit 2000 Komuna e Deçanit është udhëhequr nga këto dy parti. Zgjedhjet e para të vitit 2000 i kishte fituar LDK, e cila kishte marrë 10,136 vota, e ndjekur nga AAK me 5,552 vota dhe PDK me 881 vota. LDK në këto zgjedhje kishte siguruar 19 ulëse, AAK 10 dhe PDK 2 ulëse. Edhe në zgjedhjet e vitit 2002 LDK kishte dominuar për nga numri i votave duke fituar 9,210 vota karshi AAK me 8,674 vota. Mirëpo AAK fitoi shumicën dhe qeverisi me komunën falë përkrahjes së një anëtari të PDK. Në mandatin e dytë AAK dhe LDK kishin numër të njëjtë të ulëseve në KK, nga 15 sosh. Në zgjedhjet e vitit 2007 AAK arriti të del fituese, duke marrë gjithsej 7,806 vota apo 15 ulëse në KK. Pas ndarjes, LDK doli të jetë shumë e dobësuar në këto zgjedhje duke fituar vetëm 6 ulëse.

Gjatë këtyre tre mandateve, vetëm tri parti politike kanë arrit që të përfaqësohen vazhdimisht. KK i Deçanit është një nga kuvendet me numrin më të vogël të partive që kanë arrit të përfaqësohen, edhe pse në tri palë zgjedhjet kanë konkurruar 15 parti. Tabela 2 paraqet partitë që kanë siguruar ulëse në KK dhe numrin e votave të

fituara. Nga mandati i ardhshëm, Kuvendi Komunal i Deçanit do të ketë 4 ulëse më pak.

Tab.2. Partitë të cilat kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK të Deçanit.

| Partia | Zgjedhjet 2000 |             | Zgjedhjet 2002 |             | Zgjedhjet 2007 |             |
|--------|----------------|-------------|----------------|-------------|----------------|-------------|
|        | Nr. i Votave   | Ulëse në KK | Nr. i Votave   | Ulëse në KK | Nr. i Votave   | Ulëse në KK |
| PDK    | 881            | 2           | 606            | 1           | 904            | 2           |
| LDK    | 10136          | 19          | 9210           | 15          | 2961           | 6           |
| AAK    | 5552           | 10          | 8674           | 15          | 7806           | 15          |
| LDD    | -              | -           | -              | -           | 3401           | 6           |
| AKR    | -              | -           | -              | -           | 1105           | 2           |

Numri i votuesve ka shkuar duke rënë gjithnjë në tri palë zgjedhjet e gjertanishme lokale. Përderisa në zgjedhjet e para lokale dalja e votuesve ishte 79.9%, dy vite më vonë ajo ra në 60.4%. Ndërkaq, në zgjedhjet e vitit 2007 dalja në votime ra në 48.9%. Në përgjithësi në komunat e Kosovës përderisa numri i qytetarëve me të drejtë vote ka shkuar duke u rritur, numri i pjesëmarrësve në votime ka shkuar duke rënë. Në zgjedhjet e 15 nëntorit 2009 të drejtë vote në këtë komunë kanë 35,722 qytetarë.

Tab.3. Statistikat e daljes së votuesve në zgjedhjet lokale në Deçan në tri palë zgjedhjet e gjertanishme

|                              | 2000  | 2002   | 2007  | 2009  |
|------------------------------|-------|--------|-------|-------|
| Votues me të drejtë vote     | 21738 | 31725  | 33413 | 35722 |
| Pjesëmarrja në votime        | 17360 | 19175  | 16329 | -     |
| Përqindja e daljes në votime | 79.9% | 60.44% | 48.9% | -     |

## Buxheti i Komunës

Buxheti i Komunës së Deçanit për vitin 2009 është 4,239,773 euro. Po të krahasohet me buxhetin e vitit paraprak, Deçani këtë vit ka një buxhet më të madh për 1,088,514 euro. Në të vërtetë buxheti i vitit 2009 është më i madhi që ka pasur komuna ndonjëherë, apo dyfishi i buxhetit të vitit 2003. Komuna e Deçanit mesatarisht ka pasur një buxhet rreth 3 milion euro ku shumica e mjeteve zakonisht është shpenzuar për rroga dhe mëditje. Vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe investimeve kapitale, ku vetëm gjatë vitit 2009 janë ndarë mbi 1.2 milion euro, që njëherit është edhe shuma më e madhe e investuar për projekte kapitale.

Tab.4. Shpenzimet buxhetore sipas viteve dhe sipas linjave buxhetore

| Viti | Rrogat dhe mëditjet | Mallrat dhe shërbimet | Shpenzimet komunale | Subvencionet dhe transferet | Shpenzimet kapitale | Gjithsej   |
|------|---------------------|-----------------------|---------------------|-----------------------------|---------------------|------------|
| 2009 | €2,598,590          | €268,076              | €131,033            | €10,000                     | €1,232,074          | €4,239,773 |
| 2008 | €2,173,647          | -                     | €118,280            | €10,000                     | €547,540            | €3,151,259 |
| 2007 | €2,078,055          | €330,082              | €116,391            | €10,000                     | €463,041            | €2,997,569 |

|             |            |          |         |         |            |            |
|-------------|------------|----------|---------|---------|------------|------------|
| <b>2006</b> | €2,289,604 | €434,267 | €78,484 | €10,000 | €752,449   | €3,564,804 |
| <b>2005</b> | €2,269,746 | €349,460 | €88,000 | €11,500 | €1,062,907 | €3,781,613 |
| <b>2004</b> | €2,211,389 | €434,137 | -       | -       | €851,208   | €3,632,734 |
| <b>2003</b> | €1,615,015 | €513,254 | -       | -       | €651,416   | €2,812,434 |

Buxheti i vitit 2008 është shpenzuar për 91%. Kurse në periudhën janar-qershor 2009 buxheti për këtë vit është shpenzuar për 36.8%. Në vitin 2008 të hyrat vetanake kanë qenë 383,000 € dhe Deçani ka arrit të realizoj në tërësi planin për të hyrat buxhetore. Në periudhën janar-qershor 2009 të hyrat janë për 10% më të ulëta se sa në të njëjtën periudhë të 2008.

## Investimet kapitale

Nga buxheti i përgjithshëm i Komunës së Deçanit, 29% e mjeteve janë të destinuar për investime kapitale. Për dy vitet e fundit, investimet kapitale me të hyrat vetanake kapin shumën prej 1.7 milion euro. Tabela 5 paraqet disa nga projektet që janë realizuar me këtë buxhet për këto dy vite.

Tab.5.: Investimet kapitale në Deçan gjatë 2008 dhe 2009

| Viti | Emri i projektit                              | Shuma e Projekteve |
|------|---|--------------------|
| 2008 | Asfaltimi i qendrës                           | 183,046 €          |
| 2008 | Asfaltimi i rrugës në Strelc të Ulët          | 100,000 €          |
| 2008 | Asfaltimi i rrugës Lumbardh-Danishoc          | 84,192 €           |
| 2008 | Asfaltimi i rrugës Irzniq-Qendresë            | 100,000 €          |
| 2008 | Asfaltimi i rrugës Pobergje                   | 60,000 €           |
| 2009 | Asfaltimi i rrugës Irzniq-Pozhar-Isniq-Strelc | 210,000 €          |
| 2009 | Rruga e qytetit Carrabreg-Dautaj              | 250,000 €          |
| 2009 | Kanalizmi i ujërave të zeza                   | 200,000 €          |

Buxhetin e destinuar për investime kapitale në 2008, Komuna e Deçanit e ka realizuar për 70%. Kurse për periudhën janar-qershor 2009, buxheti i investimeve kapitale është realizuar për 14.8%. Në 3 vitet në vijim (2010-2012), buxheti i komunës së Deçanit vlerësohet të jetë 14,652,499 euro, prej të cilave 4,934,559 euro do të dedikohen për investime kapitale.

Tab.6.: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Deçanit 2010-2012

| Buxheti                            | 2010      | 2011      | 2012      |
|------------------------------------|-----------|-----------|-----------|
| <b>Buxheti i përgjithshëm në €</b> | 4,751,808 | 4,863,990 | 5,036,701 |
| <b>Të hyrat vetanake në €</b>      | 500,641   | 516,535   | 531,435   |
| <b>Investimet kapitale në €</b>    | 1,564,322 | 1,598,763 | 1,771,474 |

Nëse mund të bëjmë një përlllogaritje të përafërt edhe për vitin 2013, në bazë të përlllogaritjeve të buxhetit të gjertanishëm, mund të konkludojmë se për katër vitet në vazhdim, buxheti i Komunës së Deçanit për investime kapitale do të jetë afër 7 milion €.



## Administrata komunale

Numri i përgjithshëm i stafit arsimor, shëndetësor dhe administrativ në Komunën e Deçanit është 813. Krahasuar me vitin 2008, kjo komunë nga ngritur numrin e stafit për 2 persona. Ndërkaq, numri i të punësuarve në administratën komunale është 104. Sipas vendimit 10/46 të Qeverisë së Kosovës, komuna e Deçanit duhet të ketë jo më shumë se 120 shërbyes civil. (1 shërbyes civil për 620 banorë). Nga kjo mund të konstatojmë se administrata komunale e Deçanit ka të drejtë të rrisë numrin e stafit të saj.

Tab.7. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Deçanit sipas viteve

| Viti | Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë |
|------|--|
| 2009 | 813 ▲  |
| 2008 | 811 ▲  |
| 2007 | 810  |
| 2006 | 915  |
| 2005 | 937  |
| 2004 | 957 ▲  |
| 2003 | 914 ■  |

Për dallim nga komunat tjera, përqindja e stafit me kualifikim superior në administratën e Deçanit është shumë më e lartë, ku nga 104 punonjësit në administratë 54.6% kanë shkollim superior. 25% e punonjësve në administratë janë të gjinisë femërore. Zyrat e vendit, të cilat lëshojnë dokumentacionin e nevojshëm duke u bazuar në vendbanimet e qytetarëve, në vend se të funksionojnë nëpër fshatra më afër banorëve, ato janë të përqendruara të gjitha në objektin e Kuvendit Komunal. Zyrat e vendit janë të ndërtuara në Izniq, Strellc dhe Drenocit i kanë të ndërtuara objektet nëpër këto fshatra. Këto objekte kanë filluar të shkatërrohen ende pa hyrë në funksion.

## Komuna e Deçanit dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, kuvendi komunal duhet të mbajë të paktën 10 mbledhje. KK i Deçanit ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje, duke tejkaluar kështu normën e paraparë. Kurse gjatë periudhës janar-qershor 2009, kuvendi komunal i kësaj komune ka mbajtur 5 mbledhje, duke përmbushur kështu normën e paraparë me nenin 43.2 të ligjit të lartpërmendur. Edhe Komiteti për politikë dhe financa ka funksionuar normalisht, ku gjatë vitit 2008 është takuar gjithsej 10 herë, kurse në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 ka mbajtur gjithsej 6 mbledhje. Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik të komunës.

Sa i përket bashkëpunimit me qytetarët, komuna e Deçanit ka mbajtur 3 tubime publike gjatë vitit 2008, kurse brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2009, ajo ka mbajtur një. Sa i përket kërkesave për qasje në dokumentet zyrtare, nuk ka ndonjë të



dhënë nëse komuna e Deçanit ka pranuar një gjë të tillë. Qytetarët për këto dy vite nuk kanë dorëzuar asnjë peticion në komunë.

Ueb faqja e KK Deçan është e mirëmbajtur vazhdimisht. Është e pajisur me informacione të konsiderueshme aq sa një qytetari të Deçanit do t'i nevojiteshin rreth aktiviteteve të komunës. Është mjaft mirë e dizajnuar. Por disa kategori ende nuk janë të mbushura mirë me informacione

Tab.8. Niveli i përmbajtjes së informacioneve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Deçanit ([www.decan-komuna.org](http://www.decan-komuna.org))

| Kategoritë e informacioneve                        | Niveli i informatave <sup>2</sup> |
|--|-----------------------------------|
| Ballina  | 5                                 |
| Organizimi komunal                                 | 3.33                              |
| Shërbimet komunale                                 | 3                                 |
| Info rreth qytetit                                 | 3.5                               |
| Projektet komunale                                 | 2                                 |
| Lajme& lajmërim                                    | 2                                 |
| Harta e faqes                                      | 1                                 |
| Kontakt  | 5                                 |
| Gjuhët   | 5                                 |
| Fusha për kërkim                                   | 5                                 |
| Tjera informacione shtesë                          | 3                                 |
| Baza Ligjore                                       | 3                                 |
| Mesatarja totale                                   | 3.40                              |
| Renditja në krahasim me ueb faqet e komunave tjera | 7                                 |

## Gjendja në arsim

Arsimi në komunën e Deçanit zhvillohet në tri nivele; parashkollor, fillor dhe të mesëm. Në sistemin parashkollor janë të përfshira 18 paralele shkollore me gjithsej 512 nxënës, kurse numri i shkollave fillore është 20 duke përfshirë edhe paralelet e ndara. Në shkollat fillore mësimin e vijojnë 6,298 nxënës. Komuna e Deçanit ka edhe 3 shkolla të mesme ku vijojnë mësimin 1,873 nxënës. Kjo komunë ka 475 mësimdhënës, apo 1.1 punonjës të arsimit për 100 banorë, statistikë kjo që nuk është e kënaqshme krahasuar me komunat tjera që kanë mesatarisht 1.3 punonjës për 100 banorë. Vlen të cekët se komuna e Deçanit ka edhe një paralele speciale për nxënësit me aftësi të kufizuara.

## Gjendja në shëndetësi

Shërbimet themelore shëndetësore në Komunë janë të organizuara sipas sektorit publik dhe privat. Funkcionon Shtëpia e shëndetit "Adem Ukëhaxhaj" që është duke bërë implementimin e pjesshëm të Mjekësisë Familjare si formë të veçantë të organizimit të Kujdesit Primar Shëndetësor. Ka një hapësirë të objektit prej 1600 m/2

<sup>2</sup> Radhitja nga 1 deri 5: 5 - shkëlqyeshëm, 4-shumë mirë, 3-mirë, 2-mjaftueshëm, dhe 1-dobët.

dhe ofron shërbime të ndryshme si vijon: Urgjenca, Gjinekologjia me maternitet, Mjekësia familjare, Oftalmologjia, Interna, RTG, Laboratori, Praktika e përgjithshme, Vaksinimi, Patronazha, Stomatologjia, Pediatria, ORL. Në kuadër të këtij institucioni shëndetësor ekziston edhe Barnatorja. Në kuadër të Shtëpisë së Shëndetit puna është organizuar në tri Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe shtatë ambulanca. Numri i punëtorëve shëndetësor në komunën e Deçanit është 123, kurse numri i mjekëve është 35. Ndërkaq, një nga sfidat me të cilat përballet shëndetësia në komunën e Deçanit është mungesa e buxhetit të mjaftueshëm, ngase buxheti i ndarë për shëndetësi për mallra dhe shërbime është vetëm 45,000 euro me të cilat plotësohen vetëm 35% e nevojave që ka sistemi shëndetësor në këtë komunë. Komuna e Deçanit ka 2.3 punëtor shëndetësor për 1,000 banorë duke e futur këtë komunë në rangun e komunave me staf më të pakët shëndetësor në Kosovë.

## Shoqëria civile

Në komunën e Deçanit ka shumë organizata qeveritare të regjistruara, mirëpo vetëm një numër i vogël prej tyre janë aktive. Organizata joqeveritare “Jeta” është organizatë e cila ka për qëllim emancipimin e gruas duke ofruar edukim, këshillim, si dhe kurse të ndryshme. Shoqata e Intelektualëve të Pavarur – SHIP, është organizata më aktive e komunës së Deçanit. Kjo organizatë bën monitorimin e pushtetit lokal dhe ka për qëllim ngritjen e vetëdijesimit në shoqërinë civile, ndikimin në pushtetin lokal që të jenë më transparent, të rris përgjegjësitë e udhëheqësve duke respektuar premtimet dhe nevojat e qytetarëve, etj. Gjatë muajve Prill – Korrik SHIP ka organizuar debate të ndryshme rreth rolit të deputetit përball elektoratit dhe qytetarit; ndërmarrjet publike komunale, shërbimet dhe sfidat; siguria, qasja e organeve dhe komunitetit, etj, të cilat kanë zgjuar interesim të madh tek qytetarët duke debatuar dhe së fundi duke dhënë rekomandimet konkrete, të cilat më pas janë dërguar në adresat e duhura brenda kuvendit komunal të Deçanit. Mirëpo, sipas SHIP-it këto kërkesa shpesh hasin në vesh të shurdhër, duke lënë kështu pak hapësirë për përmirësime. Përndryshe në Deçan funksionojnë edhe OJQ të tjera sikurse Vizioni i Shekullit 21, KMLDNJ, Shoqata e Veteranëve të Luftës së UÇK, etj.

## Mediat lokale

Në komunën e Deçanit funksionon një radio lokale, Radio Top Iliria. TV Syri i Gjakovës, TV Dukagjini i Pejës dhe RTK-ja (televizioni publik) janë të shikuara në Deçan. Për media e shkruara komuna e Deçanit ka vetëm një korrespondent nga e përditshmja “Zëri”, i cili njëherazi është edhe anëtar i asamblesë komunale.

## Rendi dhe ligji në Komunën e Deçanit

Nga 1 janari 2008 deri 31 dhjetor 2008, në Komunën e Deçanit kanë ndodhur **1533** raste të shkeljes së rendit dhe ligjit, në gjithsejtë **55 shkelje të natyrave të ndryshme**. Shkeljet më të mëdha kanë ndodhur në këto fusha:

Tab.9. Numri i rasteve më të shpeshta të shkeljes së rendit dhe ligjit në Deçan (2008)

| Natyra e shkeljes së rendit dhe ligjit | Numri i rasteve të shënuara |
|--|-----------------------------|
|--|-----------------------------|

|   |     |
|---|-----|
| Aksidente                                       | 118 |
| Prishja e rendit dhe qetësisë publike           | 63  |
| Pengim i personave zyrtar në kryerjen e punës   | 29  |
| Vjedhje e pyjeve                                | 168 |
| Incidente lidhur me pronën                      | 57  |
| Vjedhje   | 147 |
| Abuzime seksuale                                | 7   |
| Shkaktim të dëmtimeve trupore                   | 43  |
| Kërcënime                                       | 60  |
| Mashtrime                                       | 6   |
| Vrasje  | 7   |
| Incidente në baza etnike, religjioze apo racore | -   |

Në komunën e Deçanit janë shënuar gjithsej 118 aksidente komunikacioni gjatë vitit 2008. Kjo komunë qëndron lart në listë për nga numri i madh i vjedhjes së pyjeve, ku gjatë vitit 2008 janë shënuar 168 raste të vjedhjes së pyjeve. Ndërsa sa i përket rasteve të vrasjeve gjatë vitit të kaluar janë shënuar 7 raste të vrasjeve dhe 60 kërcënime.

## Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përlogariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifat tatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05% dhe 1% të vlerës së pronës në treg. Tarifat e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore. Në bazë të kësaj, Kuvendi Komunal i Deçanit ka miratuar Rregulloren komunale për tatim në pronë me të cilën ka caktuar zonat e komunës, normën tatimore dhe çmimin e pronës në treg.

Tab.10. Tatimi në pronë në Komunën e Deçanit

| Zona        | Pronë për banim                            |        | Prona komerciale | Prona Industriale | Prona bujqësore |
|-------------|--|--------|------------------|-------------------|-----------------|
|             | Banesa                                     | Shtëpi |                  |                   |                 |
|             | <b>Norma tatimore</b>                      |        |                  |                   |                 |
|             | 0.10%                                      | 0.10%  | 0.25%            | 0.20%             | 0%              |
| <b>Zona</b> | <b>Vlera e tregut për metër katror (€)</b> |        |                  |                   |                 |
| <b>I</b>    | 400  | 400    | 700              | 300               | 200             |
| <b>II</b>   | 350  | 350    | 600              | 250               | 150             |
| <b>III</b>  | 300  | 300    | 500              | 200               | 100             |
| <b>IV</b>   | 200  | 250    | 400              | 200               | 100             |

## Kostoja për biznese

Në Komunën e Deçanit janë të regjistruara rreth 480 biznese. Bizneset janë të regjistruara në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, kurse leja e punës u lëshohet nga administrata komunale e Deçanit. Duke u bazuar në Rregulloren komunale për taksa, gjoba dhe ngarkesa, më poshtë kemi pasqyruar disa nga bizneset më të zakonshme dhe shumat e mjeteve që ato duhet të paguajnë për leje të punës.

Tab.11. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

| Lloji i biznesit  | Taksa vjetore e punës (€) |
|---|---------------------------|
| Bankat  | 350                       |
| Kompanitë e sigurimit   | 350                       |
| KEK   | 500                       |
| PTT   | 250                       |
| Hotelet   | 300                       |
| Motelet   | 250                       |
| Supermarketet-Hipermarketet   | 200                       |
| Vetëshërbimet - Minimarketet  | 75                        |
| Restorantet   | 200                       |
| Kafeteritë  | 170                       |
| Gurëthyesit   | 250                       |
| Depot e materialit ndërtimor  | 250                       |
| Autoshkollat  | 200                       |
| Punëtoritë (argjendaritë, zdrukthëtaritë, automekanikët, bukëpjekësit, floktarët, etj.)   | 70 - 100                  |
| Ndërmarrjet ndërtimore  | 250                       |
| Agjencitë turistike   | 170                       |
| Pompat e benzinës   | 100- 350                  |
| Veprimtaritë e pavarura profesionale (mjekët, stomatologët, avokaturat, arkitektët, etj.) | 100 - 200                 |

## Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shtator-tetor, 2009.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2009. (<http://mef-rks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012 - raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale deri më 30 shtator 2009.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë - të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa - të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2007 "Jeta në Kosovë", [www.jetanekosove.com](http://www.jetanekosove.com).
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report - Kosovo 2004.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunat e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2008.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës - janar-dhjetor 2008. Janar, 2009.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës - janar-qershor 2009. Shtator, 2009.
12. MASHT. Statistikat e Arsimit në Kosovë. Prishtinë, 2009.
13. Policia e Kosovës. Statistika ne lidhje me raste të ndryshme kriminale dhe aksidente të komunikacionit. 24 gusht 2009.
14. Komisioni Qendror Zgjedhor. Zgjedhjet komunale 2000, 2002 dhe 2007. Si dhe listat e votuesve me të drejtë vote për zgjedhjet e 2009.
15. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndihmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2009.
16. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2008.